



Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, nxjerr:

**VENDIM SHPJEGUES PUBLIK NR. 04/2015
PËR
TRANSAKSIONET E MULLINJVE**

QËLLIMI

Qëllimi i këtij Vendimi Shpjegues Publik është të sqaroj trajtimin tatimor të aktivitetit ekonomik të mullinjve për transaksionet, si në vijim:

- Shërbimi që lidhet me procesin e bluarjes së drithërave;
- Transaksionet e këmbimit të mallrave (miell, hime/krunde, etj.);
- Shitje të prodhimeve të gatshme (miell, hime/krunde, etj.);
- Blerja e grurit nga fermerët.

BAZA LIGJORE

Aktiviteti ekonomik i mullinjve për aspekte tatimore është trajtuar sipas dispozitave ligjore, si në vijim:

- Neni 2, paragrafi 1, nënparagrafi 1.9 i Ligjit Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar - Transaksioni barter;
- Neni 10, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar - Furnizimi i mallrave;
- Neni 14, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar - Furnizimi i shërbimeve;
- Neni 45 i Ligjit Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar - Përmbajtja e faturave të lëshuara nga personi i tatueshëm për personin e tatueshëm;
- Neni 46 i Ligjit Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar - Përmbajtja e një fature të lëshuar nga personi i tatueshëm për personin tjetër;
- Neni 60 i Ligjit Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar - Skema e normës së sheshtë për bujqit;

- Neni 76 i Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2015 për zbatimin e Ligjit Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar - Aplikimi i normës së sheshtë për produktet bujqësore të furnizuara nga bujqit;
- Neni 10 i Ligjit Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale - Të ardhurat nga aktivitetet afariste;
- Neni 40 i Ligjit Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale - Mbajtja e Tatimit në Burim për Kategori të Veçanta;
- Neni 5 i Ligjit Nr. 05/L-029 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave - Të ardhurat e tatueshme;
- Neni 31 i Ligjit Nr. 05/L-029 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave - Mbajtja e Tatimit në Burim për Kategori të Veçanta.

I. SHËRBIMI QË LIDHET ME PROCESIN E BLUARJES SË DRITHËRAVE

a) Trajtimi për TVSH

Shërbimi që lidhet me procesin e bluarjes së drithërave i njohur si “Shërbim i bluarjes”, nënkupton ofrimin e shërbimit të bluarjes së drithërave sipas porosisë dhe në llogari të pronarit të tyre. Ky është furnizim i shërbimit sipas nenit 14 të Ligjit Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

Çmimi i shërbimit (konsiderata) i cili njihet si “ujem”, mund të merret në mjete monetare apo jo-monetare, respektivisht në sasi të drithit.

Nëse konsiderata për shërbimin nuk përbëhet nga paratë ose që nuk përbëhet plotësisht nga paratë, vlera e saj duhet të trajtohet sipas vlerës së hapur të tregut.

Shembull:

Një fermer apo kooperativë bujqësore dërgon në mulli 100,000kg. grurë për bluarje. Çmimi i caktuar për shërbime të bluarjes është 20% e vlerës së grurit. Nëse çmimi për kg është 0,20€, atëherë:

$100,000\text{kg.} \times 0.20\text{€} = 20,000.00\text{€}$ - vlera totale e grurit

$20,000 \times 20\% = 4,000.00\text{€}$ - vlera me TVSH e shërbimit të bluarjes së grurit.

Pra, nga mulliri lëshohet fatura tatimore për pagesë sipas kreut 15 të Ligjit Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, respektivisht sipas nenit 45 (për persona të tatueshëm) apo nenit 46 (për personat tjerë), me këto elemente llogaritëse:

$4,000.00 / 1.18 = 3,389.83\text{€}$Shuma e tatueshme
$3,389.83 \times 18\% = 610.17\text{€}$TVSH e llogaritur
$3,389.83 + 610.17 = 4,000.00\text{€}$Vlera totale për pagesë.

b) Trajtimi për Tatimin në të Ardhura Personale apo Tatimin në të Ardhurat e Korporatës

Vlera e shërbimit (qoftë në para apo drithëra) që lidhet me provizionin për bluarje (ujemin) përbën të hyrën nga shërbimet e bluarjes (në shembullin e mësipërm 3,050.85€ - nëse ofruesi i shërbimit është deklarues i TVSH-së apo 3.600,00€ - nëse ofruesi i shërbimit nuk është deklarues i TVSH-së).

Ndërsa, kosto të zbritshme do të lejohen të gjitha kostot direkte dhe indirekte për krijimin e këtyre të hyrave.

II. TRANSAKSIONET E KËMBIMIT TË MALLRAVE (miell, hime/krunde, etj.)

a) Trajtimi për TVSH

“Transaksion këmbimi” nënkupton rastin kur mallrat këmbehen me ekuivalencën e caktuar. Sipas nenit 2, paragrafit 1, nënparagrafit 1.9 të Ligjit Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, ky transaksion konsiderohet “transaksion barter”, citojmë:

“1.9. Transaksioni barter - një transaksion i cili përfshin dy palë, ku njëra palë siguron për palën tjetër mallin, shërbimin ose mjetin me përjashtim të parave të gatshme, në këmbim për mallin, shërbimin ose mjetin me përjashtim të parave të gatshme”.

Shembull:

Nëse nga fermeri dorëzohen 100,000 kg. grurë në mullin, me qëllim të këmbimit me miell apo hime (krunde), atëherë kemi transaksion të këmbimit. Në këtë rast nga të dyja palët (fermeri dhe mulliri) kërkohet t'i faturojnë njëri – tjetrit për mallrat respektive, siç vijon:

- a. Nëse fermeri është person i tatueshëm (i regjistruar për TVSH) lëshon faturë të shitjes për 100,000 kg. grurë me çmim të tregut prej 0.20€/për kg. për mullirin.
 $100,000 \times 0.20\text{€} = 20,000.00\text{€}$ (përfshirë TVSH-në).
Fatura duhet t'i përmbaj të gjitha elementet e kërkuara sipas nenit 45 të Ligjit Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.
- b. Nëse fermeri është person jo i tatueshëm (nuk është i regjistruar për TVSH) lëshon faturë të shitjes për 100,000kg. grurë me çmim të tregut prej 0.20€/për kg. për mullirin.
 $100,000 \times 0.20\text{€} = 20,000.00\text{€}$.

- c. Nëse fermeri si person fizik jo afarist lidh marrëveshje me mullirin për këmbimin e mallrave (grurë me prodhime prej grurit, si miell, hime/krunde, etj.), atëherë mulliri lëshon faturë interne në emër të fermerit, e cila do të konsiderohet faturë blerëse për mullirin.

Shembull

Llogaritja e vlerësimit të ekuivalencës së këmbimit:

Fermeri dorëzon 100,000 kg. grurë në mull, me qëllim të këmbimit të mallrave me ekuivalencë të vlerës së njëjtë.

Marrëveshja në mes të fermerit dhe mullirit është lidhur për këmbimin e mallrave për rastet si në vijim:

1. Fermeri dorëzon grurin, si:

Përshkrimi	Sasia	Çmimi për kg.	Vlera
Grurë	100,000	0.20€	20,000€
Totali			20,000€

2. Mulliri këmben mallrat, si:

- a. Si kundërvlerë jep miell dhe hime (krunde):

Përshkrimi	Sasia	Çmimi për kg.	Vlera
Miell	52,000	0.3327	17,300€
Hime	30,000	0.09	2,700€
Totali			20,000€

- b. Si kundërvlerë jep vetëm miell:

Përshkrimi	Sasia	Çmimi për kg.	Vlera
Miell	60,115	0.3327	20,000
Totali			20,000

- c. Si kundërvlerë jep vetëm hime (krunde):

Përshkrimi	Sasia	Çmimi për kg.	Vlera
Hime	222,225	0.09	20,000
Totali			20,000

b) Trajtimi për Tatimin në të Ardhura Personale apo Tatimin në të Ardhurat e Korporatës

Me rastin e transaksionit të këmbimit të mallrave, si prodhime të gatshme (miell apo hime/krunde) me drithëra, nuk realizohen të hyra, meqenëse kemi vetëm ndërrim strukture të mallrave dhe vlera e mallrave të këmbyerë është e barabartë.

Të hyrat pritet të realizohen në të ardhmen përmes procesit të përpunimit, respektivisht bluarjes së drithërave dhe shitjes së prodhimeve të gatshme.

III. SHITJA E PRODHIMEVE TË GATSHME (miell, hime/krunde, etj.)

a) Trajtimi për TVSH

Nëse mulliri shet prodhimet e tij të gatshme, transaksioni i tillë është furnizim i mallrave, ashtu siç është përcaktuar në nenin 10 të Ligjit Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

b) Trajtimi për Tatimin në të Ardhura Personale apo Tatimin në të Ardhurat e Korporatës

Të hyrat e realizuara nga shitja e prodhimeve të gatshme të mullirit trajtohen si çdo e hyrë tjetër e tatueshme.

Kosto e mallrave të shitura është përmbledhja e kostove direkte dhe indirekte për krijimin e të hyrave përkatëse.

IV. BLERJA E GRURIT NGA FERMERËT

Nëse mulliri blen prodhimet nga fermeri (bujku), transaksioni trajtohet varësisht nga ajo se fermeri a është person afarist apo person fizik jo afarist.

a) Trajtimi për TVSH

Nëse fermeri si person fizik jo afarist lidh marrëveshje me mullirin për shitjen e grurit, atëherë mulliri lëshon faturë interne në emër të fermerit, e cila do të konsiderohet faturë blerëse për mullirin. Nëse fermeri (shitësi i grurit) posedon dokumentin e regjistrimit si fermer pranë Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, mulliri aplikon skemën e normës së sheshtë për blerjen e grurit nga fermeri.

Shembull:

Mulliri ka blerë 2,000 kg. grurë nga fermeri (prodhuesi bujqësor) me çmim prej 0.20€ /për kg. Aplikimi i normës së sheshtë për TVSh, bëhet si në vijim:

Norma e sheshtë = 8%

Sasia	a	2,000 kg
Çmimi për njësi	b	0.20€
Vlera	c= a x b	400.00€
TVSH e zbritshme	d= c / 13.5	29.63 €
Vlera pa TVSH	e= c-d	370.37€

b) Trajtimi për Tatimin në të Ardhura Personale apo Tatimin në të Ardhurat e Korporatës

- Nëse fermeri si person fizik jo afarist lidh marrëveshje me mullirin për shitjen e grurit, atëherë mulliri lëshon faturë interne në emër të fermerit, e cila do të konsiderohet faturë blerëse për mullirin. Pavarësisht se fermeri (shitësi i grurit) posedon apo jo dokumentin e regjistrimit si fermer pranë Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, mulliri është i obliguar që për pagesën të cilën i bënë personit fizik jo afarist, të ndal tatimin në burim në shkallën prej 3%.

Shembull:

Mulliri ka blerë 2,000 kg. grurë nga fermeri (prodhuesi bujqësor) me çmim prej 0.20€ /për kg.

Sasia	Çmimi për kg	Vlera për pagesë
2,000 kg	0.20€	400.00€

Mulliri është i obliguar që Tatimin në Burim në shkallë prej 3% ta ndal në pagesën bruto 400.00€. Pra, $400.00€ \times 3\% = 12.00€$ Tatim i Mbajtur në Burim nga mulliri. Për ndaljen e tatimit në burim, mulliri dorëzon pasqyrën e tatimit të mbajtur në burim dhe e transferon shumën e tatimit të mbajtur në burim në llogarinë e caktuar nga ATK në një bankë, apo institucion financiar, të licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas ditës së fundit të secilit muaj kalendarik

- Nëse fermeri dhe mulliri janë persona fizik afarist apo persona juridik, transaksioni do të trajtohet si çdo transaksion tjetër në kuadër të aktivitetit të rregullt ekonomik.

Data: 01/12 /2015

U.D. Drejtori i Përgjithshëm, ATK

(Nahit Sharku)

